



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Punëjeto/Prodato Received/Delivered	21.12.2021	viti god year	
Organ /Njesia Org /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHUK	6241/2021		1/4



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.Nr.988/2021

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.Nr.2933/19 të datës 15.11.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka shqyrtuar ankesën A.Nr.656/2019 të datës 25.10.2019, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi: Rr."Beqir Musliu ", Nr.108, Gjilan, kundër organit të punësimit Komuna e Gjilanit, në çështjen juridike " kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 20.12.2021, mori këtë:**

### V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën A.Nr.656/2019 të datës 25.10.2019, të parashtruar nga ankuesja

### A r s y e t i m

Ankuesja me datë 25.10.2019, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokollit 105336 të datës 26.08.2019 të Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Gjilanit, për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm për pozitën e punës Drejtor i Shkollës se Mesme të Lartë „ Adem Kastrati " në Gjilan, të shpallur sipas konkursit të datës 27.06.2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes Njoftimit me numër protokollit 5246/2019 të datës 07.11.2019, ka njoftuar ankuesen së në mungesë të anëtarëve nuk ka mundur të shqyrtoj ankesën A.Nr. 656/2019 të datës 25.10.2019 dhe ka udhëzuar të njëjtën me të drejtën e hapjes së konfliktit administrativ pranë gjykatës kompetente gjegjësisht Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 15.11.2021, ka nxjerr Aktgjykim me numër A.Nr.2933/19, me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditëses, ka anuluar njoftimin e Këshillit të datës 07.11.2019 dhe ka obliguar te njëjtin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A.Nr.656/2019 të datës 25.10.2019.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar:** Ankesën A Nr.656/2019 e datës 25.10.2019, me numër protokolli 5029/2019 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formulari për kërkesë apo ankesë i datës 24.09.2019; Njoftimin e datës 15.10.2019; Ankesën e datës 24.09.2019, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Formuari "E"; Formuari "C"; Formulari "C"; Formulari "C"; Formulari "C"; Përgjigje në ankesë e datës 11.11.2019; Kërkesë e datës 07.06.2019; Autorizimin e datës 21.06.2019, të Ministrisë së Administratës Publike; Konkursin e datës 27.06.2019; Vendimin për emërimin e komisionit për intervistimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për pozitën Drejtorë dhe Zëvendës drejtor të Institucioneve edukativo arsimore dhe aftësuese në Gjilan i datës 14.08.2019; Listën e kandidatëve të mundshëm për Drejtorë të Shkollave i datës 20.08.2019; Formulari për kërkesë apo ankesë i datës 11.07.2019; Kërkesën për punësim e me shkresa të bashkangjitura: Formulari për kërkesë apo ankesë i datës 08.07.2019; Kontrata e punës e datës 01.09.2015; Diplomë e datës 01.08.2013; Diplomë me nr. 157 e datës 05.08.2004; Licencë e datës 11.09.2017; Vërtetim i datës 04.02.2019; Plani Zhvillimor i Shkollës; Mirënjohje e datës 22.12.2006; Mirënjohje e datës 10.12.2018; Mirënjohje e datës 08.06.2015; Mirënjohje e datës 07.03.2003; Mirënjohje e datës 17.02.2019; Referencë e datës 07.03.2018; Mirënjohje e datës 16.12.2016; Mirënjohje e datës 25.10.2014; Mirënjohje e datës 12.05.2017; Mirënjohje e datës 20.11.2010; Mirënjohje e datës 30.06.2001; Certifikatë e datës 20.10.2015; Vërtetim i datës 09.03.2018; Licencë e Mësimdhënësit e datës 11.09.2017; Vërtetim i datës 12.03.2018; Kontratë Pune e datës 01.10.2015; Kontratë Pune e datës 15.02.2016; Referencë e datës 22.05.2018; Certifikatë e datës 20.11.2015; Kërkesën për punësim e me shkresat e bashkangjitura: Referencë e muajit Shtator 2010; Referencë e datës 19.07.2002; Mirënjohje e datës 19.09.2015; Certifikatë e datës 30.06.2001; Certifikatë e vitit 2009; Mirënjohje e datës 13.06.2015; Mirënjohje e datës 24.12.2009; Mirënjohje e datës 15.06.2016; Mirënjohje e datës 27.12.2004; Mirënjohje e datës 18.12.2008; Mirënjohje e datës 28.12.2010; Mirënjohje e datës 07.10.2012; Mirënjohje e datës 15.05.2015; Certifikatë e datës 30.05.2016; Certifikatë e datës 31.05.2001; Certifikatë e datës 16.03.2003; Certifikatë e datës 01.10.2006; Certifikatë nga Qendra Rajonale për Aftësim Profesional; Certifikatë e vitit 2014; Certifikatë e datës 10.12.2015; Certifikatë e datës 08.07.2011; Certifikatë e datës 03.08.2001; Certifikatë e datës 02.07.2019; Certifikatë shëndetësore e datës 26.06.2019; Certifikatë e lindjes; Diplomë me nr.32 e datës 14.01.2009; Diplomë me nr.400 i datës 07.04.2010; Plani Zhvillimor i Shkollës (PZHSH) 2019; Certifikatë e muajit qershor 2018; Protokolli i Intervistimit i datës 19.08.2019; Formuari "D"; Formuari "H"; Formuari "H"; Formuari "H"; Formuari "H"; Formuari "H"; Formuari "H"; Formuari "D"; Protokolli i Intervistimit i datës 19.08.2019; Protokolli i Intervistimit i datës 19.08.2019; Formuari "D"; Protokolli i Intervistimit i datës 19.08.2019; Protokolli i Intervistimit i datës 19.08.2019; Protokolli i Intervistimit i datës 19.08.2019; Formuari "D"; Formuari "D"; Formuari "D"; Vendim i datës 26.08.2019; Pliko me nr. R8075574 e datës 07.11.2019; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 29.10.2019; E-mail nga B.A. për R.K. i datës 10.12.2019; Aktgjykim A.nr.2933/19 i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative i datës 01.12.2021; Përgjigje në ankesë e datës 5323/2019.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit të Aktgjykimit A.Nr.2933/19 të datës 15.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses** sepse:

Nga vlerësimi i shkresave të lëndës është konstatuar se ankuesja ka aplikuar në Konkursin e shpallur nga Komuna e Gjilanit me datë 27.06.2019 për pozitën Drejtor i Shkollës së Mesme të Lartë "Adem Kastrati", në Gjilan. Organi i punësimit gjegjësisht Drejtoria e Arsimit në Komunën e Gjilanit, me datë 26.08.2019, përmes Vendimit me numër protokolli 105336 ka shpallur kandidatin si kandidat me të suksesshëm për pozitën në fjalë.

E pakënaqur me Vendimin me numër protokolli 105336 të datës 26.08.2019, ankuesja me datë 09.10.2021, parashtron ankesë në Komunën e Gjilanit, ndërsa kjo e fundit përmes shkresës zyrtare ka njoftuar ankuesen se me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/për Zyrtarët Publikë me datë 12.09.2019, ankesa parashtrohet drejtpërdrejtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil. Pas këtij njoftimi ankuesja me datë 25.10.2019 ushtron ankesë me bazë të njëjtë ankimore në KPMSHCK.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke ju referuar dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 2 paragrafi 4 ku përcaktohet se: **4. Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike**, ka konstatuar se zyrtaret publikë të nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të Institucioneve Publike të Arsimit Para Universitar në Kosovë, kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publik respektivisht pozita e Drejtorit të Shkollës së Mesme nuk hyn në kategorinë e nëpunësve civil, andaj duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses

Bazuar në nenin 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji udhëzon ankuesen se nëpunësi i shërbimit publik ka të drejtë të ankohet të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.



Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër Nr.988/2021

**Rushi KAJTAZI**

Procesmbajtës

**Ardita HAXHNIKAJ DEMI**

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Gjilanit;
- Udhëheqëses së Personelit në Komunën e Gjilanit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.